

Përgjegjës në Sektorin e Kërkimit-Zhvillimit, në Drejtorinë e Kërkimit, Zhvillimit dhe Inovacionit, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Ligjit nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 147, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor””, të ndryshuar dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 65 datë 19.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor shpall konkurimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Përgjegjës në Sektorin e Kërkimit - Zhvillimit, në Drejtorinë e Kërkimit, Zhvillimit dhe Inovacionit, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

1. Është përgjegjës për drejtimin e sektorit në funksion të realizimit të detyrave lidhur me kërkimin dhe zhvillimin, në bashkëpunim edhe me drejtoritë e tjera teknike.
2. Menaxhon punën për ngritjen dhe zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe anëtarësimeve me organizmat simotër rajonale, europiane, etj., dhe me partnerët nga sektori publik, privat.
3. Bashkëpunon për përthithjen e fondeve nga projekte apo donatorë vendas apo të huaj.
4. Menaxhon asistencën teknike për politikatat, programet dhe projektet që lidhen me zhvillimin dhe inovacionin.
5. Raporton në mënyrë periodike mbi veprimtarinë e sektorit pranë Drejtorit të Drejtorisë mbi proceset që lidhen me kërkimin dhe zhvillimin.
6. Bashkëpunon për përgatitjen e draft-akteve nënligjore që lidhen me informacionin gjeohapësinor sipas sektorëve përkatës.
7. Bashkëpunon me institucionet kërkimore shkencore dhe të inovacionit.
8. Ndjek në vazhdimësi politikatat dhe analizën e të dhënave në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, objektivat e SKZHI dhe Planin Kombëtar për Integrimin European me institucionet përgjegjëse.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

- Të këtë mbaruar studimet e larta e të zotërojë një diplomë të nivelit "Master shkencor", profili Shkenca Ekonomike/Juridike.

- Të ketë të paktën 3 (tre) vite eksperiencë pune në profesion.
- Kualifikime përkatëse në fushat e Menaxhimit të Biznesit, Kërkimit apo të ngjashme.
- Përvojë me sektorin jofitimprurës duke punuar për organizata jofitimprurëse.
- Të ketë marrë pjesë apo kontribuar në hartim politikash, strategjish dhe implementim të tyre.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi e negociimi.
- Të ketë aftësi të mira drejtimi (leadership), komunikimi, negociimi, gjykim e iniciative për t'u marrë me probleme komplekse.
- Të njohë organizatat e ndryshme të BE, të cilat orientojnë politikat komunitare lidhur me infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor.
- Të njohë mirë gjuhën angleze, edhe njohja e gjuhëve të tjera është prioritet.
- Të njohë programet kompjuterike.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (III-a/1)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 20.08.2023, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në adresën: Rruga "Papa Gjon Pali II", Nd. 2, H.3, Kati 2, Tiranë ose në adresën e e-mailit info@asig.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka)
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të paktën një letër rekomandimi
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t'u kontaktuar

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.